



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

QENDRA E TRAJNIMIT TË ADMINISTRATËS
TATIMORE DHE DOGANORE

RAPORT VJETOR

I VEPRIMTARISË

2024

Tabela e Përmbajtjes

QËLLIMI.....	4
OBJEKTIVAT.....	5
VEPRIMTARITË NË PËRPUTHJE ME KUADRIN E RI LIGJOR.....	6
PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE.....	7
1. Veprimtari trajnuese.....	7
2. Veprimtari ligjore.....	8
3. Vlerësimi i cilësisë së trajnimeve nga pjesëmarrësit.....	8
4. Studime në fushën fiskale.....	9
4.1 Edukimi fiskal në shkolla dhe rëndësia e tij.....	9
4.2 Impakti i tatimit në ekonomi.....	9
5. Trajnimi i trajnerëve.....	9
6. Trajnime me kërkesë nga institucione të tjera publike.....	10
VEPRIMTARITË NË FUSHËN E EDUKIMIT FISKAL.....	10
1. Trajnimet.....	10
2. Programet e trajnimit.....	10
3. Pjesëmarrësit në trajnime.....	11
4. Numri i orëve të trajnimit.....	11
5. Vlerësimi i njohurive të punonjësve niveli bazë-administrata tatimore.....	11
6. Vlerësimi i njohurive të punonjësve niveli bazë-administrata tatimore.....	12
7. Metodat trajnuese.....	12
ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE.....	13
Programet e trajnimit për vitin 2024.....	14
AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE.....	15
Trajnime të punonjësve vazhdues.....	15
Foto nga trajnimet me punonjësit vazhdues të administratës doganore.....	20
Trajnime të nivelit funksional.....	21
Foto nga trajnimet me punonjësit funksional të administratës doganore.....	29
Trajnime të punonjësve të rinj.....	30
Foto nga trajnimet me punonjësit niveli bazë të administratës doganore.....	39

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA TATIMORE	41
<i>Trajnime të punonjësve niveli bazë</i>	41
Foto nga trajnimet me punonjësit e rinj të administratës tatimore	50
<i>Trajnime të punonjësve niveli vazhdues</i>	52
Foto nga trajnimet me punonjësit vazhdues të administratës tatimore	59
<i>Trajnime të punonjësve niveli funksional</i>	60
Foto nga trajnimet me punonjësit e nivelit funksional të administratës tatimore	67
Aneks I- Tabela e të dhënave për trajnimet me administratën tatimore.	68
Aneks II- Tabela e të dhënave për trajnimet e administratës doganore	72
Aneks III- Tabela përmbledhëse për trajnimet me administratën tatimore dhe doganore.....	77
Aneks IV- Statistikat e cilësisë së trajnimeve nisur nga formularet e vlerësimit të trajnimit dhe trajnerëve nga ana e pjesëmarrësve.....	78
Aneks V- Analiza për realizimin e buxhetit nga financës dhe shërbimet mbështetëse	79

QËLLIMI.

Pasqyrimi i veprimtarisë së institucionit në fushën ligjore, organizative dhe trajnuese.

Veprimtaria trajnuese e Qendrës është zhvilluar në funksion të përmirësimit të kapaciteteve të punonjësve të organeve fiskale dhe të orientimit të të trajnuarve në kuptimin e përgjegjësive të tyre teknike, profesionale duke pasur në vëmendje që:

-Synimi i Shqipërisë për të arritur anëtarësimin në BE, kërkon absorbimin e legjislacionit dhe administrimin e sistemit fiskal nga ana e burimeve njerëzore, si edhe krijimin e një kulture që promovon profesionalizmin e punonjësve.

-Përmirësimi i performancës dhe kultivimi i një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e vlerave, sjelljeve dhe njohurive profesionale mund të krijojë një administratë fiskale me të kualifikuar dhe me integritet. Një administratë fiskale e trajnuar dhe e motivuar do të ofronte shërbime më të mira dhe cilësore.

-Krijimi i një shërbimi trajnues cilësor është synimi jonë për zhvillimin e një sistemi të mirë trajnues dhe ofrimin e mundësive të vazhdueshme për trajnim për të gjithë punonjësit e administratës fiskale gjatë gjithë periudhës së tyre të shërbimit.

-Trajnimi ndikon drejtpërdrejtë në krijimin e dijeve të duhura teknike për të zbatuar siç duhet ligjet dhe për të administruar sistemin, performanca e mirë e kryrjes së të cilave ndikon jetën e çdo qytetari shqiptar që kontribuon në të ardhurat publike dhe njëkohësisht përfiton prej tyre.

OBJEKTIVAT.

Qendra ka pasur në veprimtarinë e saj të 2024 këto objektiva kryesore:

Implementini i reformës së Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, nëpërmjet zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602 datë 14.09.2022, “Për Krijimin, **Organizimin** dhe Funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (QTATD)” dhe akteve nënligjore në zbatim.

Strukturë e re organike të miratuar që përfshin trajnerë të brendshëm.

Hartimi i programeve të duhura të trajnimit për administratën fiskale tatimore e doganore sipas nevojave të DPT dhe DPD.

Organizimi i trajnimeve në mënyre efektive dhe efçente.

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i workshopeve drejt çështjeve praktike duke zbatuar parimet e reja të mësimdhënies për të rriturit.

Krijimi i njohurive të reja dhe zgjerimi i njohurive ekzistuese rreth sistemit fiskal dhe ligjor nëpërmjet trajnimeve, duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të njohurive mes kategorive të ndryshme të punonjësve të Administratës Tatimore dhe Doganore, aftësimin e tyre praktik dhe teorik.

Realizimi i studimeve në fushën e edukimit fiskal.

VEPRIMTARITË NË PËRPUTHJE ME KUADRIN E RI LIGJOR.

VKM-ja e re Nr. 602 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, datë 14.09.2022 hyri në fuqi në 2023 dhe QTATD funksionoi gjatë 2024 në bazë të specifikimeve ligjore që përcaktohen aty lidhur me organizimin e trajnimeve dhe angazhimin e trajnerëve.

Në zbatim të kësaj VKM-je kërkohet strukturë e re organizative që të përfshinte edhe trajnerë të brendshëm.

Për këtë u hartua draft-struktura organizative e Qendrës me 14 punonjës, relacionet shpjeguese dhe kalkulimet financiare, e cila u miratua me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 46, datë 19.03.2024 për “Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”.

Në bazë të strukturës së re u hartuan draft rregulloret e brendshme dhe të trajnimit.

U hartuan tre lloje të programeve të trajnimit:

- të rinjtë-niveli bazë,
- niveli funksional,
- niveli vazhdues.

Për punonjësit e rinj u aplikuan programet afat-mesëm, që i dhanë mundësi të rinjve të krijojnë dhe konsolidonin njohuri në çdo fushë.

Për nivelin funksional, pjesëmarrësit nga tatimet dhe nga doganat, thelluan njohuritë e tyre teorike dhe praktike për një fushë të caktuar, të lidhur me detyrat e tyre funksionale.

Për punonjësit vazhdues u hartuan dhe zbatuan programe specifike, duke përfshirë atë të ndryshimeve ligjore të ligjit të tatimit mbi të ardhurat.

PËRMBLEDHJE E VEPRIMTARIVE.

Në zbatim të VKM, nr.602, datë 14.09.2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore”, u hartuan programet dhe u planifikua organizimi i trajnimeve për 3 kategori programesh si me poshtë:

1. VEPRIMTARI TRAJNUESE

TRAJNIME		
•	Trajnimit bazë	<p>Organizuar për punonjësit dhe nëpunësit e rinj të administratës tatimore dhe doganore me qëllim që të pajisen me njohuri të rëndësishme themelore përkatëse të çdo fushe.</p> <p>Sipas këtij programi u trajnuan :</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>Administrata tatimore: 33 punonjës në 13 tema- 120 orë trajnimi.</i>• <i>Administrata doganore: 48 punonjës në 17 tema- 108 orë trajnimi.</i>• Total: 81 punonjës të rinj, të trajnuar në 30 tema, 228 orë trajnimi.
•	Trajnimit Vazhdues	<p>Organizuar për të gjithë punonjësit dhe nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore, me qëllimin që të krijohen njohuri të reja për çështje të veçanta dhe përditësimin e atyre ekzistuese, sipas dinamikave të fushës dhe të shkëmbehen përvojat dhe të transferohen njohuritë dhe dialogu ndërmjet stafit, lidhur me përditësimin me legjislacionin dhe praktikën e reja të zbatueshme.</p> <p>Sipas këtij programi u trajnuan :</p> <ul style="list-style-type: none">• <i>Administrata tatimore: 393 punonjës në 8 tema- 162 orë trajnimi</i>• <i>Administrata doganore: 327 punonjës në 8 tema- 240 orë trajnimi.</i>• Total: 720 punonjës vazhdues, të trajnuar në 16 tema, me 402 orë trajnimi

<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimin Funkcional 	<p>Organizuar për punonjësit dhe nëpunësit e administrates tatimore dhe doganore, për specializim në vendin e punës ose për zhvillimin e karrierës, ku njohuritë themelore dhe të përgjithshme thellohen përmes trajnimit që lidhet me funksionet përkatëse administrative.</p> <p>Sipas këtij programi u trajnuan :</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Administrata tatimore: 264 punonjës në 10 tema- 72 orë trajnimi.</i> • <i>Administrata doganore: 284 punonjës në 17 tema- 102 orë trajnimi.</i> • <i>Total: 548 punonjës funksionalë, të trajnuar në 27 tema, me 174 orë trajnimi</i>
--	---

2. VEPRIMTARI LIGJORE

VEPRIMTARITË SIPAS KUADRIT TË RI LIGJOR
<ul style="list-style-type: none"> • U miratua struktura e re organizative e QTATD-së, ku u shtua një drejtori në përbërje të së cilës do të jenë trajnerë të brendshëm.
<ul style="list-style-type: none"> • U draftuan programet e reja të trajnimit mbi bazën e specifikimeve ligjore.
<ul style="list-style-type: none"> • U draftuan detyrat dhe rregullat sipas kuadrit të ri ligjor, rregullore e brendshme dhe ajo e trajnimit.

3. VLERËSIMI I CILËSISË SË TRAJNIMEVE NGA PJESËMARRËSIT

<ul style="list-style-type: none"> • Numri total i pjesëmarrësve që morën pjesë në vlerësim: 1771.
<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimet u vlerësuan nga : <ul style="list-style-type: none"> ➤ 1728 ose 97.6% e pjesëmarrësve: shumë mirë ➤ 43 ose 2.4% e pjesëmarrësve: mirë ➤ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: mjaftueshëm ➤ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët
<ul style="list-style-type: none"> • Trajnerët u vlerësuan nga : <ul style="list-style-type: none"> ➤ 1724 ose 97.3% e pjesëmarrësve: shumë mirë ➤ 44 ose 2.5% e pjesëmarrësve: mirë ➤ 2 ose 0.15% e pjesëmarrësve: mjaftueshëm ➤ 1 ose 0.05% e pjesëmarrësve: dobët

4. STUDIME NË FUSHËN FISKALE

4.1 Edukimi fiskal në shkolla dhe rëndësia e tij

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore përgatiti studimin krahasimor me temë: “Edukimi fiskal në shkolla dhe rëndësia e tij” të cilin e ka publikuar në faqen zyrtare të web (www.qtatd.gov.al).

Studimi krahasimor “Edukimi fiskal në shkolla dhe rëndësia e tij”, ka qëllim të tregojë rëndësinë që ka përfshirja e edukimit fiskal në shkolla, e cila ndihmon brezat e rinj dhe qytetarët të kuptojnë dhe pranojnë përgjegjësitë e tyre fiskale, pasi luan një rol të drejtpërdrejtë në rritjen e të ardhurave në kushtet kur llogaritja e pagesa e tatimeve bazohet në parimin e vetëdeklarimit. Edukimi i tatimpaguesve nga ana e shtetit rrit shkallën e kuptimit të detyrimeve dhe të drejtave të çdo tatimpaguesi, ekzistues dhe sidomos të ardhshëm duke ulur koston e pajtimit vullnetar me detyrimet tatimore si dhe koston e administrimit nga ana e organeve fiskale.

4.2 Impakti i tatimit në ekonomi

Një tjetër studim i përgatitur nga Qendra përgjatë vitit 2024 dhe i publikuar në faqen zyrtare të web është “Impakti i tatimit në ekonomi”. Ky studim ka qëllim të tregojë sesi tregues të ndryshëm tatimor mund të ndikojnë në ekonomi. Në studim janë paraqitur sistemet tatimore, shkollat teorike të studimit tatimor, si edhe politikat fiskale. Gjithashtu janë marrë në shqyrtim efektet që prodhojnë disa prej llojeve të ndryshme të tatimit, efekti që ka TVSH-ja në rritjen ekonomike dhe lidhja e të ardhurave personale në ndikimin ekonomik. Duke qenë se Shqipëria është tanimë vend kandidat për tu bërë pjesë e BE, në studim flitet edhe mbi politikat tatimore të BE-së dhe ndikimin që kanë ato në shtetet anëtare.

5. TRAJNIMI I TRAJNERËVE

Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore në vitin 2024 zhvilloi trajnimin e trajnerëve, me individët të cilët angazhohen pranë Qendrës si mësimdhënës, qofshin këta të rinj, po ashtu edhe ata që kanë kohë të angazhuar si trajnerë.

Trajnimi për trajnerët e administratës tatimore dhe për të administratës doganore, ju dha mundësinë pjesëmarrësve të njiheshin me konceptet bashkëkohore të procesit trajnues, specifikisht duke u fokusuar në faktin se në qendër të trajnimit duhet të jetë pjesëmarrësi. Në këtë kuadër u trajtuan disa prej metodologjive për angazhimin e pjesëmarrjes aktive gjatë procesit trajnues dhe format më të mira të prezantimit të trajnimit nga ana e mësimdhënësve.

6. TRAJNIME ME KËRKESË NGA INSTITUCIONE TË TJERA PUBLIKE

Përgjatë vitit 2024 u zhvillua trajnimi “Ndërveprimi i ligjit për falimentimin me ligjin për procedurat tatimore (Ligji i Falimentit)” fokusuar në procedurat tatimore për fillimin e procesit të falimentit, me pjesëmarrës punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Falimentimit. Trajnimi u zhvillua përgjatë dy ditëve në sallën e trajnimeve të QTATD.

Trajnimi ishte interaktiv dhe me raste praktike si nga gjykata, ashtu edhe nga puna e përditshme e Agjencisë. Gjatë trajnimit u diskutuar dhe roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si një prej nismëtarëve për procedurat e falimentit dhe si njësisia kryesore që mund të përfitojë nga asetet e ndryshme në përfundim të procesit.

VEPRIMTARITË NË FUSHËN E EDUKIMIT FISKAL.

1. TRAJNIMET

Programet e Trajnimit përfshinin çështje bazë dhe specifike që lidhen me të kuptuarit e kuadrit ligjor, administrimit si dhe të ndryshimeve ligjore të fushës fiskale. Pjesë të programit ishin tema trajnimi që përfshijnë dhe thellimin e njohurive të pjesëmarrësve në kuadër të trajnimeve me nivelin funksional.

Përzgjedhja e temave të trajnimit u mbështet kryesisht në kërkesat e administratave fiskale, në bazë të identifikimit që ato i bëjnë nevojave për trajnim në tema dhe njerëz, si edhe në sugjerimet e pjesëmarrësve dhe të trajnerëve dhe u paraqitën për diskutim dhe për miratim në Këshillin Konsultativ të Qendrës

2. PROGRAMET E TRAJNIMIT

<ul style="list-style-type: none">• Administrata tatimore: miratuar 31 tema trajnimi për 3 kategori pjesëmarrësish (të rinj, vazhdues dhe funksional).
<ul style="list-style-type: none">• Administrata doganore: miratuar 42 tema trajnimi për 3 kategori pjesëmarrësish (të rinj, vazhdues dhe funksional).
<ul style="list-style-type: none">• Të dy administratat tatimore dhe doganore: miratuar 73 tema në total.
<ul style="list-style-type: none">• ToT (Trajnim i Trajnerëve): 1 temë
<ul style="list-style-type: none">• Trajnimi për institucione të tjera: miratuar “Ndërveprimi i ligjit për falimentimin me ligjin për procedurat tatimore (Ligji i Falimentit)”: 1 temë

3. Pjesëmarrësit në Trajnime

• Pjesëmarrës në trajnime nga administrata tatimore për vitin 2024- 690 punonjës.
• Pjesëmarrës në trajnime nga administrata doganore për vitin 2024 - 659 punonjës.
• Pjesëmarrës në Trajnimin e Trajnerëve: 10 punonjës
• Pjesëmarrës në trajnimin mbi falimentin: 11 punonjës

4. Numri i Orëve të Trajnimit

• Orë të trajnimit për administratën tatimore për vitin 2024: 354 orë.
• Orë të trajnimit për administratën doganore për vitin 2024: 450 orë.
• 804 orë total për të dy administratat.
• Orë të trajnimit për ToT: 18 orë
• Orë të trajnimit për Falimentin: 12 orë

5. Vlerësimi i Njohurive të Punonjësve Niveli Bazë-Administrata Tatimore

• Numri total i pjesëmarrësve që morën pjesë në testim: 29
• Pjesëmarrësit u vlerësuan: <ul style="list-style-type: none">➤ 1 ose 4% e pjesëmarrësve: shkëlqyer➤ 22 ose 76% e pjesëmarrësve: shumë mirë➤ 6 ose 20% e pjesëmarrësve: mirë➤ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: dobët

6. VLERËSIMI I NJOHURIVE TË PUNONJËSVE NIVELI BAZË-ADMINISTRATA TATIMORE

<ul style="list-style-type: none">• Numri total i pjesëmarrësve që morën pjesë në testim: 48
<ul style="list-style-type: none">• Pjesëmarrësit u vlerësuan:<ul style="list-style-type: none">➤ 0 ose 0% e pjesëmarrësve: shkëlqyer➤ 22 ose 46% e pjesëmarrësve: shumë mirë➤ 23 ose 48% e pjesëmarrësve: mirë➤ 3 ose 6% e pjesëmarrësve: dobët

7. METODAT TRAJNUESE

Diskutime të rasteve praktike - me qëllimin që punonjësit të vihen në rolin e vendim marrësit që përballet me një problem, cdo seminar është fokusuar në diskutimin e zgjidhjeve të rasteve praktike si mënyrë e të kuptuarit dhe marrjes pjesë aktive të të rriturve në mësim.

Trajnerë nga radhët e stafit të organeve fiskale- me qëllim përmirësimin e kompetencave të pjesëmarrësve në një fushë specifike, përdoret metoda e demonstrimit të procesit të reflektimit dhe zgjidhjes së problemeve të teorisë dhe praktikës.

Diskutime të çështjeve praktike të hasura nga vetë pjesëmarrësit- me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale, përdoret metoda e angazhimit në ndarjen e çështjeve që shqetësojnë me njëri-tjetrin, si edhe mësimin me kolegët me të cilët kanë të njëjtin objektiv për të arritur.

Leksione studimore – përdoret me qëllim që të zgjidhen dilema lidhur me mënyrën e leximit dhe interpretimit të neneve të veçanta të ligjeve fiskale.

Konsultime – për të promovuar ndërgjegjësimin e inspektoreve dhe zhvillimin e tyre profesional nëpërmjet ofrimit dhe rekomandimit të mundësive të strukturuar për reflektim dhe observim.

Mbikqyrje reflektive - për të mbështetur, zhvilluar dhe vlerësuar punën e trajnerëve dhe performancën e pjesëmarrësve nëpërmjet një procesi pyetësorësh që inkurajon të kuptuarin dhe artikullimin e të arsyeshmes gjatë mësimdhënies dhe mësimarrjes.

Asistencë teknike - për të ndihmuar individët e organeve fiskale të përmirësohen, nëpërmjet ofrimit të informacioneve dhe burimeve të legjislacionit primar e sekondar, udhëzuesëve e manualeve sipas punës që mbulon secili dhe detyrave në përputhje me punën.

Testime – për të verifikuar shkallën e njohurive që zotërojnë, njohurive që marrin dhe për të vlerësuar nevojat e mëtejshme për trajnim specifik.

ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE.

Qendra hartoi **kalendarët** e trajnimeve si mjet për organizimin dhe zhvillimin e duhur të trajnimit të kërkuar profesional të punonjësve të administratës tatimore dhe doganore.

Qendra **planifikoi** veprimtaritë e saj bazuar në filozofinë e zhvillimit ose përmirësimit profesional gjatë të punuarit të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me efektivitetin në punë si dhe të cilësive profesionale që kanë të bëjnë me detyrat e përditshme të vendit të punës. Inspektorëve të tatimeve dhe punonjësve të doganave ju dha mundësia e **zhvillimit profesional pa pagesë** gjatë trajnimeve të përgatitura nga një nivel i lartë profesional trajnerësh dhe që varion gjerësisht në lidhje me filozofinë, përmbajtjen dhe formatin e eksperiencave të të mësuarit.

Orientimi i trajnerëve dhe organizimi i trajnimeve u fokusua drejt seminarëve praktikë, duke zbatuar parimet e mësimdhënies për të rriturit.

Trajnimet u zhvilluan në sallë, duke krijuar mundësinë e ndërveprimit aktiv mes pjesëmarrësve dhe trajnerëve.

Trajnimet u zhvilluan gjithashtu në degë të ndryshme tatimore dhe doganore, duke mundësuar jo vetëm organizimin e trajnimit, por dërgimin e trajnimit tek pjesëmarrësi. Trajnerët duke qenë se mbulojnë në jetët e tyre profesionale, si pjesë e organeve fiskale, çështjet teknike që diskutohen, përveç koncepteve teorike janë orientuar drejt shpjegimit të rasteve konkrete nga praktika e punës, duke ia bërë më të prekshme temën e trajnimit pjesëmarrësve dhe duke pasur mundësinë që të ofrojnë zgjidhje ose unifikim interpretimesh.

PROGRAMET E TRAJNIMIT PËR VITIN 2024.

U hartuan dhe miratuan në fillim të vitit programet e trajnimit si më poshtë:

ADMINISTRATA TATIMORE: 3 PROGRAME TRAJNIMI

- Programi i Trajnimit për **punonjësit e rinj, 13 Tema, 20 ditë, 120 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin funksional, 10 Tema, 12 ditë, 72 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin vazhdues, 8 Tema, 12 ditë, 72 orë trajnimi për çdo rajon.**

ADMINISTRATA DOGANORE: 3 PROGRAME TRAJNIMI

- Programi i Trajnimit për **punonjësit e rinj, 17 Tema, 18 ditë, 108 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin funksional, 17 Tema, 17 ditë, 102 orë trajnimi.**
- Programi i Trajnimit për **nivelin vazhdues, 8 Tema, 8 ditë, 48 orë trajnimi, për çdo rajon.**

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve:

- U koordinua midis institucioneve në lidhje me pjesëmarrësit në këto trajnime.
- U përzgjedhën dhe u koordinua me trajnerët në lidhje me metodologjinë që përdoret në trajnimet në sallë si dhe në lidhje me materialet e prezantimit dhe dokumentat shoqërues për secilin trajnim.
- U hartuan e dërguan kalendarët e trajnimit.
- U zhvilluan seminarët.
- U dërguan materialet e trajnimeve për pjesëmarrësit, si edhe u ndoqën e përpunuan formularët e vlerësimit për trajnimin.

AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve vazhdues

AKTIVITETI I

“Klasifikimet Tarifore dhe IDT”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 29 pjesëmarrës në total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Vlorë me 4 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 7 pjesëmarrës, në degën doganore Tiranë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 8 pjesëmarrës dhe në degën doganore Kakavijë me 4 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Nomenklatura e kombinuar e mallrave;
- Nomenklatura e Sistemit të Harmonizuar (SH) të Organizatës Botërore të Doganave;
- Nënndarjet, që i janë bërë nomenklaturës së SH-së, të quajtura ndryshe edhe “nënkrerë të NKM-ve”, të cilave u përgjigjet një nivel i caktuar i taksës doganore;
- Dispozitat paraprake, shënimet shtesë për seksionet, kapitujt dhe shënimet fundore për nënkrerët e NKM-ve;
- Tarifën doganore/nivele të ndryshme taksash sipas llojit të mallrave;
- Mbledhjen e statistikave të tregtisë ndërkombëtare;
- Rregullat e origjinës.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me procedurat e klasifikimeve tarifore të mallrave. Ky trajnim u zhvillua për thellim njohurish për punonjësit e administratës doganore në lidhje me përdorimin e nomenklaturës së mallrave.

AKTIVITETI II

“Operacionet e privileguara.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 39 pjesëmarrës në total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Kakavijë me 4 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Tiranë me 5 pjesëmarrës dhe në degën doganore Vlorë me 4 pjesëmarrës.

ÇËSH TJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Operacionet e privileguara;
- Përfshirjet nga detyrimet doganore;
- Procedurat për IDT dhe IDO;

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me operacionet e privileguara. Ky trajnim u zhvillua për thellim njohurish për punonjësit e administratës doganore në lidhje me këtë fushë.

AKTIVITETI III

“Asycuda World, Oracle. Kutitë, kodet dhe plotësimi i DAV.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 54 pjesëmarrës në total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Shkodër me 12 pjesëmarrës, në degën doganore Tiranë me 22 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 4 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 9 pjesëmarrës, dhe në degën doganore Vlorë me 7 pjesëmarrës.

ÇËSH TJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Përdorimin e programit ASYCUDA WORLD;
- Plotësimi i kutive;
- Përdorimi i Oracle;
- Plotësimi i raporteve në Asycuda dhe Oracle.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me përdorimin e programit Asycuda World dhe Oracle. Ky trajnim u zhvillua për përditësimin e njohurive për punonjësit e administratës doganore në lidhje me ndryshimet në këtë fushë.

AKTIVITETI IV

“Laboratori doganor dhe mostrimi.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 54 pjesëmarrës në total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore

Tiranë me 11 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 5 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 10 pjesëmarrës, dhe në degën doganore Korçë me 8 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Udhëzimin mbi “Procedurat e mostrimit, transportimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve të analizave laboratorike”;
- Manuali i mostrimit;
- Marrja e mostrës;
- Veprimet për të adresuar rreziqet dhe mundësitë;

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me procedurat e marrjes së mostrave doganore. Ky trajnim u zhvillua për thellimin e njohurive për punonjësit e administratës doganore në këtë fushë.

AKTIVITETI V

“IPR- Pronësia intelektuale.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 31 pjesëmarrës në total në 5 degë doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 5 pjesëmarrës, në degën doganore Shkodër me 7 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 3 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 7 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Patentat dhe modelet e përdorimit;
- Disenjt industrial;
- Markat tregtare dhe të shërbimit;
- Treguesit gjeografikë;
- Qarqet e integruar.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me pronësinë intelektuale, markat dhe patentat, nisjen e procedurave. Ky trajnim u zhvillua për thellimin e njohurive për punonjësit e administratës doganore në këtë fushë.

AKTIVITETI VI

“Operatori Ekonomiki Autorizuar”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 49 pjesëmarrës total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 8 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 6 pjesëmarrës dhe në degën doganore Shkodër me 8 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë nënkupton statusi OEA?
- Kush mund të aplikojë për statusin OEA?
- Baza ligjore mbështetëse
- Llojet e autorizimeve OEA
- Kriteret
- Përfitimet
- Procedurat që ndiqen për aplikim
- Aneksi 12 & 13

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur statusin e OEA-ve. Si përfitohet, procedurat që ndiqen dhe lehtësitë që u ofrohen.

AKTIVITETI VII

“Platforma Click. Modulet online WCO.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 53 pjesëmarrës total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 14 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 9 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 10 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 6 pjesëmarrës dhe në degën doganore Shkodër me 10 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë nënkupton statusi OEA?
- Kush mund të aplikojë për statusin OEA?
- Baza ligjore mbështetëse
- Llojet e autorizimeve OEA

- Kriteret
- Përfitimet
- Procedurat që ndiqen për aplikim
- Aneksi 12 & 13

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur statusin e OEA-ve. Si përfitohet, procedurat që ndiqen dhe lehtësitë që u ofrohen.

AKTIVITETI VII

“RREZIQET E KORRUPSIONIT NË ADMINISTRATËN DOGANORE.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit vazhdues të Administratës Doganore, me 33 pjesëmarrës total në 5 degët doganore në pozicionet specialist dhe doganier, respektivisht në degën doganore Tiranë me 7 pjesëmarrës, në degën doganore Vlorë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Kakavijë me 6 pjesëmarrës, në degën doganore Korçë me 8 pjesëmarrës dhe në degën doganore Shkodër me 7 pjesëmarrës.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Integriteti dhe masat anti-korrupsion qasja parandaluese;
- Integriteti dhe masat anti-korrupsion qasja ndëshkuese;
- Njohja e parimeve të nivelit të lartë kundër korrupsionit në Dogana G20.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rreziqet e korrupsionit në administratën doganore.

Foto nga trajnimet me punonjësit vazhdues të administratës doganore



AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të nivelit funksional

AKTIVITETI I

“Origjina e Mallrave (nivel i avancuar).”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 19 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Informacion mbi Nomeklaturen e R.Sh;
- Tarifa Preferenciale e R.SH;
- Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë;
- Rregullat e Origjinës së mallrave;
- Rregullat e Origjinës Preferenciale;
- Konventa PEM ekzistuese dhe e amenduar.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me zhvillimet e fundit të rregullave të origjinës preferenciale bazuar në Konventën PEM, të njihen me rregullat e origjinës preferenciale bazuar në Marrëveshjen e Partneritetit dhe bashkëpunimit tregtar me Mbretërinë e Bashkuar; të njihen me rregullat e origjinës preferenciale bazuar në Konventën PEM , të njihen me rregullat e origjinës preferenciale bazuar Rregullat Tranzitore të Konventës PEM, të identifikohen ndryshimet bazë në dy setet e rregullave të origjinës preferenciale, ato të Konventës dhe Rregullat Tranzitore, të njohin kumulimin e plotë të origjinës bazuar në dy setet e rregullave të origjinës.

AKTIVITETI II

“Vlera Doganore (nivel i avancuar).”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 18 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rendësia e vlerësimit doganor të mallrave;
- Metodat e vlerësimit;
- Transferimi i çmimit;
- Diskutim raste praktike.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rëndësinë e vlerësimit doganor të mallrave, metodat e vlerësimit, transferimin e çmimit, diskutimin e rasteve praktike për të përmisuar kapacitetet profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.

AKTIVITETI III

“Lejimi i përkohshëm. RLP me përjashim të plotë. Magazinat doganore dhe zonat e lira. Përpunimi aktiv. Përpunimi pasiv.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 23 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- RLP me përjashim të plotë;
- Magazinat doganore dhe zonat e lira;
- Përpunimi aktiv;
- Përpunimi pasiv.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me regjimet doganore, përpunimin aktiv dhe pasiv, diskutimin e rasteve praktike të paraqitura pranë degëve doganore.

AKTIVITETI IV

“Akciza - përjashtimet, diferencat, rimbursimi, inventarizimi. Përjashtimet, diferencat, rimbursimi, inventarizimi.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 21 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Përjashtimet;
- Diferencat;
- Rimbursimi;
- Inventarizimi.

Objekti ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me rëndësinë e akcizës, përjashtimet nga akciza, diferencat, rimbursimi, inventarizimi, diskutimi rasteve praktike.

AKTIVITETI V

“Akciza - dispozita produkte specifike. Dispozita për produktet specifike.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 14 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Lindja e detyrimit të akcizës dhe deklarimi;
- Përjashtimet dhe rimbursimet;
- Lëvizja e produkteve të akcizës, tipet e lëvizjes;
- Dokumentet shoqëruese të produkteve të akcizës dhe destinacioni;
- Garancitë, llojet e garancive, forma dhe masa e garancisë;
- Çlirimi i garancisë;
- Humbjet dhe firot;
- Kontrolli i produkteve specifike të akcizës.

Objektivi ishte trajnimi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore mbi akcizën, dispozitat për produkte specifike.

AKTIVITETI VI

“Kontrolli pas zhdoganimit. Analiza, kryerja dhe dokumentimi i kontrolleve, praktikë.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit e nivelit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 9 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Llojet e kontrollit;
- Rëndësia e kontrollit;
- Analiza, kryerja dhe dokumentimi i kontrolleve, praktikë.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore mbi llojet e kontrollit pas zhdoganimit, diskutimi i rasteve praktike.

AKTIVITETI VII

“Inteligjenca operative. Mbledhja dhe përdorimi i inteligjencës operative. Baza e të Dhënave Ncen (National Customs Network Database).”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Tatimore dhe Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 18 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist, përgjegjës dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Kuadri ligjor, marrëveshjet, bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Marrëveshja e nCEN dhe njohja në kohë reale me sistemin nCEN;
- Shembuj konkretë të hedhur në sistemin nCEN.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore për bazën e të dhënave nCEN si instrument i rëndësishëm në kryerjen e detyrave të përditshme në fushën e zbatimit të ligjit dhe veçanërisht inteligjencës.

AKTIVITETI VIII

“Kontrabanda: padia, zgjidhja administrative, kazuse. Padia civile në procesin penal, zgjidhja administrative e kontrabandës.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 10 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist, dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Kontrabanda. Dispozita penale për kontrabandën. Kazuse.
- Vepra të tjera penale që lidhen me veprimtarinë në fushën e doganave.
- Zgjidhja administrative e kontrabandës si rast përjashtimor. Kushtet që duhet të plotësohen.
- Padia civile në procesin penal. Kushtëzimet. Afati.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me kontrabandën, veprat penale, padinë civile, diskutimin e rasteve praktike.

AKTIVITETI IX

“Siguria kibernetike.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 18 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist, jurist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë është siguria kibernetike;
- Bazat e sigurisë kibernetike;
- Siguria e Sistemeve të Informacionit;
- Kërcënimet për sigurinë kibernetike;
- Legjislacioni në Shqipëri, strukturat përkatëse.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me legjislacionin përkatës për sigurinë kibernetike si edhe diskutimin e rasteve praktike.

AKTIVITETI X

“Rregullat alternative të origjinës preferenciale “Rregullat tranzitore””

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 20 pjesëmarrës në total në Tiranë në pozicionet specialist, jurist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rregullat e origjinës preferenciale në zbatim;
- Produkte origjinuese;
- Komulimi i plotë;
- Kthimi i detyrimeve doganore.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me legjislacionin përkatës për rregullat e origjinës si edhe diskutimin e rasteve praktike.

AKTIVITETI XI

“Ligji i TVSH, fiskalizimi dhe marrëdhënia doganë-tatime.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 30 pjesëmarrës në total, në Tiranë në pozicionet specialist, jurist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Persona e tatueshëm për TVSH;
- Furnizimet e tatueshme;
- Vlera e tatueshme;
- Shkalla tatimore;
- Furnizimet e tatueshme;
- Importi dhe rregullat për TVSH.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të sistemit fiskal dhe në veçanti konceptet bazë të ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” i ndryshuar dhe ligjit Nr.29/2023, datë 30.03.2023 ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ i ndryshuar.

AKTIVITETI XII

“Metodologjia e kontrollit fizik dhe procedurat e sekuestrimit të mallrave.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 28 pjesëmarrës në total, në Tiranë në pozicionet specialist, jurist dhe doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Procedurat që ndërmerren në rastet e kontrollit fizik;
- Kur ndodh ky kontroll;
- Dokumentet plotësuese;
- Rastet kur sekuestrohen mallrat;
- Sanksionet.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me procedurat në rastet e kontrollit fizik, dokumentet plotësuese, sanksionet.

AKTIVITETI XII

“E drejta për informim.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Tatimore dhe Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 39 pjesëmarrës në total, në Tiranë në pozicionet specialist, jurist, doganier, inspektor.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Ligji për të drejtën për informim;
- Programi i transparencës;
- Roli i koordinatorit;
- Penalitetet;
- Ndryshimet;
- Raste praktike.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore dhe doganore lidhur me ligjin për të drejtën për informim dhe programin e transparencës, diskutimin e rasteve praktike.

AKTIVITETI XIII

“Mbrotjtja e të dhënave personale.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Tatimore dhe Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 35 pjesëmarrës në total, në Tiranë në pozicionet specialist, jurist, doganier, inspektor.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Parimet;
- Çfarë është një e dhënë personale?
- Çfarë është një e dhënë sensitive?
- Të drejtat e subjektit të të dhënave;
- Siguria e të dhënave personale;
- Penalitetet.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës tatimore dhe doganore lidhur me ligjin për mbrotjtjen e të dhënave personale, diskutimin e rasteve praktike.

AKTIVITETI XIV

“Kapjet doganore (Kapje Cash).”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 17 pjesëmarrës në total, në Tiranë në pozicionet specialist, jurist, doganier.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Trafikimit i veprave të Artit;
- Lëndët Radioaktive;
- Ligjin Nr.9917 date 19.05.2008 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit".

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me trafikimin e veprave të artit, lëndëve radioaktive, parandalimit të pastrimit të parave.

AKTIVITETI XV

“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, analiza e riskut.”

Trajnimi u zhvillua për punonjësit funksional të Administratës Doganore, të cilët e kanë pjesë të detyrave funksionale të tyre, me 13 pjesëmarrës në total, në Tiranë në pozicionet financiar, specialist, jurist.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Njohja me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Njohjen me dispozitat e tjera;
- Mënyra e funksionimit.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me menaxhimin financiar dhe dispozitat respektive.

Foto nga trajnimet me punonjësit funksional të administratës doganore



AKTIVITETE TRAJNUESE ADMINISTRATA DOGANORE

Trajnime të punonjësve të rinj

AKTIVITETI I

"Nëpunësi civil, etika, konflikti i interesit"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 40 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i akcizës, sektori i regjimeve, sektori financës, hetimi doganor, nga degët doganore.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Etika.
- Konflikti i interesit;
- Struktura organizative;
- Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të ligjit të nëpunësit civil, vlerësimin në punë, shkeljet disiplinore, kodin e etikës, rastet e konfliktit të interesit.

AKTIVITETI II

"Roli i doganave dhe legjislacioni"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i Administratës Doganore. Në trajnim morën pjesë 37 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Roli dhe misioni;
- Legjislacioni doganor;
- Konventat dhe marrëveshjet;
- Legjislacioni jo doganor.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë mbi rolin e doganës dhe legjislacionin mbështetur në Kodin Doganor dhe dispozitat zbatuese të Kodit Doganor.

AKTIVITETI III

"Tarifa dhe Klasifikimi"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 42 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Tarifa doganore dhe klasifikimi i mallrave;
- Përjashtimet nga taksa doganore në import;
- Informacioni tarifor detyrues dhe trajtimi tarifor favorizues.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, klasifikimeve tarifore, nivelet e detyrimeve doganore, detyrimet e importit, masa të tjera.

AKTIVITETI IV

"Origjina e mallrave"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 40 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rregullat e Origjinës së mallrave;
- Marrëveshjet dhe kumulimi;
- Provat e origjinës.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të rregullave të origjinës së mallrave, rregullat e origjinës preferenciale dhe jo preferenciale, kumulimim bilateral, kumulimin diagonal/ rajonal, kumulimin e plotë.

AKTIVITETI V

"Vlera doganore"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 39 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Rëndësinë e vlerësimit doganor të mallrave;
- Metodat e vlerësimit;
- Databaza e vlerësimit;
- E drejta e ankimimit.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të vlerësimit doganor dhe metodave të vlerësimit.

AKTIVITETI VI

"Borxhi doganor dhe garancitë"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 39 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Konceptin e borxhit doganor;
- Si lind borxhi doganor, fazat deri në borxhin doganor;
- Kur shuhet borxhi doganor;
- Masat nëpërmjet të cilave ekzekutohet borxhi doganor;

- Praktikrat gjyqësore në rastet të rekuperimit forcërisht të borxhit doganor;
- Raste reale të ndodhura në kuadrin e borxhit doganor.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të borxhit doganor, masat, praktikrat gjyqësore.

AKTIVITETI VII

"Taksa dhe tatime të tjera."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 36 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Aplikimi i tvsh për mallrat në regjim doganor;
- Njohja me ligjin e procedurave tatimore;
- Sqarimi i taksave kombëtare, vlerat e tyre dhe organet mbledhëse.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të procedurave tatimore, tatimit mbi vlerën e shtuar, tatimit mbi të ardhurat, takave kombëtare, taksave vendore etj.

AKTIVITETI VIII

"Deklarimi, deklarata dhe regjimet"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 45 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Përfaqësimi, hyrja dhe dalja;
- Deklarata doganore;
- Verifikimi, clirimi dhe shkatërrimi.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të deklarimit, plotësimit të deklaratës, si edhe regjimeve, procedurave që ndiqet për secilin rast.

AKTIVITETI IX

" Regjimet doganore të posaçme"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 41 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Tranziti;
- Magazinimi doganor dhe zonat e lira;
- Përdorimi i veçantë; RLP dhe end use;
- Përpunimi aktiv dhe pasiv.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të regjimeve doganore, lëvizjen e mallrave, llojet e regjimeve, procedura që ndiqet për secilin rast.

AKTIVITETI X

"Akciza"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 42 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Fusha e zbatimit, detyrimi, përjashtimet;
- Klasifikimi fiskal, niveli, llogaritjet;
- Regjimet e produkteve të akcizës.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të akcizës, procedura që ndiqet për secilin rast.

AKTIVITETI XI

"Mbikqyrja dhe kontrolli doganor"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 32 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Menaxhimi i riskut, kontrollet;
- Ndalimet dhe kufizimet;
- Aposteriori.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të mbikqyrjes dhe kontrollit doganor, llojet e kontrollit, legjislacionit në fuqi.

AKTIVITETI XII

"Shkeljet dhe sanksionet në fushën e doganave"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 41 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Kundërvajtjet;
- Kontrabanda;
- Verifikimi i shkeljeve doganore;
- Shkeljet dhe sanksionet për akcizën.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të shkeljeve dhe sanksioneve në fushën doganore, trajtimi i rasteve praktike.

AKTIVITETI XIII

"Siguria kibernetike"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 39 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Çfarë është siguria kibernetike;
- Bazat e sigurisë kibernetike;
- Siguria e Sistemeve të Informacionit;
- Kërcënimet për sigurinë kibernetike;
- Pajisje celular, akses në distancë dhe mediat sociale;
- Legjislacioni në Shqipëri, strukturat përkatëse;
- Si të mbrohem.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të sigurisë kibernetike, legjislacionin në fuqi, strukturat përkatëse.

AKTIVITETI XIV

"Përdorimi i programit Asycuda World, Seed, Lims"

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 32 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Përdorimi i sistemit Asycuda World;
- Përdorimi i sistemit SEED;
- Përdorimi i sistemit Lims.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të përdorimit të sistemit Asycuda World, modulet që përdoren, veprimet mbi tranzitin, veprimet mbi

tranzitin ne doganen destinacion, veprimet mbi DEMP, veprimet mbi DAV, përdorimi i sistemit SEED, përdorimi i programit Lims.

AKTIVITETI XV

"Databaza e të dhënave (SQL, QUERY, PIVOT TABLE, VISUAL REPORT, ETL, ETJ)."

Ky trajnim u zhvillua për punonjësit e rinj në periudhë prove, niveli bazë i administratës doganore. Në trajnim morën pjesë 32 pjesëmarrës, respektivisht specialist dhe doganier nga sektori i mbikqyrjes, sektori i regjimeve, sektori financës, sektori operacional.

ÇËSHTJET KRYESORE TË TRAJTUARA

- Përdorimi i sistemit Asycuda World;
- Përdorimi i sistemit SEED;
- Përdorimi i sistemit Lims.

Objektivi ishte trajnimi i punonjësve të administratës doganore lidhur me konceptet bazë të përdorimit të sistemit Asycuda World, modulet që përdoren, veprimet mbi tranzitin, veprimet mbi tranzitin ne doganen destinacion, veprimet mbi DEMP, veprimet mbi DAV, përdorimi i sistemit SEED, përdorimi i programit Lims.

AKTIVITETI XVI

“Platforma Klik. Modulet Online WCO.”

